

Numri: KSC-BC-2020-07

Vendos: Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Hysni Gucati

Data: 29 shtator 2020

Gjuha: anglishte

Titulli i Dosjes: *Prokurori i Specializuar k. Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucati*

KLASIFIKIMI: Publik

**PJESËMARRËSIT TË CILËVE DUHET T'IU SHPËRNDAHET PARASHTRIMI:**

Gjykatësit të Vetëm, ZPS-së, Kryetares së Dhomave të Specializuara, Mbrojtësit të Specializuar për z. Haradinaj

---

**Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2):**

**Kërkesë për dhënie të informacionit**

---

Zyra e Prokurorit të Specializuar  
Valeria Boliçi (Valeria Bolici)

Mbrojtësi i specializuar për z. Gucati  
Xhonatan Elistan Ris QC

Bashkëmbrojtësi i specializuar për z. Gucati  
Valon Hasani

Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2):

Kërkesë për dhënie të informacionit

1. Parashtruesi, z. Gucati, e kundërshton ligjshmërinë e arrestimit të tij në pajtim me nenin 41(2) të Ligjit Nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji").

2. Neni 41(2) i Ligjit thotë se:

"Çdo person që privohet nga liria me anë të arrestimit ose paraburgimit ka të drejtë ... të paraqesë ankesë lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të tij ... dhe që ajo ankesë të vendoset me shpejtësi nga Dhomat e Specializuara dhe nëse ai paraburgim nuk është i ligjshëm, të urdhërohet lirimi i tij ose i saj."

3. Sipas nenit 41(6) të Ligjit, një person nuk mund të paraburgoset përveç nëse ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer krim brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

4. Në rastin aktual, parashtruesi nuk pranon:

a. se ekziston dyshimi i bazuar që ai është përgjegjës penalisht për orvatje të kryerjes së veprës penale të frikësimit gjatë procedimit penal (shih paragrafin 1 të fletarrestimit);

b. se ekziston dyshimi i bazuar se ai është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale të hakmarrjes (shih paragrafin 2 të fletarrestimit); dhe

- c. se ekziston dyshimi i bazuar se ai është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës.
5. Parashtruesi gjithashtu nuk i pranon çështjet e pretenduara në paragrafët 4, 5 dhe 6 të fletarrestimit.
  6. Kërkesa për fletarrestim u paraqit *ex parte* dhe parashtruesi nuk pati mundësi që t'i paraqiste parashtrimet e veta gjykatësit të ditur, në lidhje me provat e paraqitura para këtij gjykatësi.
  7. Kërkesa për materiale është refuzuar nga Prokuroria pa asnjë shpjegim.
  8. Provat që i janë paraqitur gjykatësit të ditur gjatë kërkesës për fletarrestim, duhet t'i jepen parashtruesit në këtë fazë, me qëllim që parashtruesi të mund të bëjë parashtrime në lidhje me to, përfshirë dhe në lidhje me pikën nëse materiali e mbështet faktikisht 'dyshimin e bazuar'.
  9. Vetë fletarrestimi thotë në paragrafin 8 se parashtruesi gëzon të drejtat sipas nenit 21 të Ligjit. Në nenin 21(6) i Ligjit kërkohet që i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në posedim të Zyrës së Prokurorit të Specializuar që janë në favor apo kundër tij t'i vihen në dispozicion *para fillimit* dhe gjatë procesit gjyqësor, objekt vetëm i kufizimeve që janë rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e masave të domosdoshme mbrojtëse kompensuese.
  10. Nuk është sugjeruar se është rreptësisht e domosdoshme të kufizohet dhënia e materialit në të cilin bazohet fletarrestimi dhe nuk janë zbatuar e as nuk mund të zbatohen masa mbrojtëse kompensuese. Pa marrjen e atij materiali, parashtruesi thjesht nuk mund të bëjë parashtrime në lidhje me të. Parashtruesi

nuk duhet të vihet në pozitë më të keqe se në rastin po të ishte arrestuar pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij (gjë që nuk ka ndodhur).

11. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, parashtruesit duhet t'i jepen i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në favor të parashtruesit ose kundër tij, me qëllim që parashtruesi të mund të kundërshtojë materialin mbi bazën e të cilit është kërkuar fletarrestimi, dhe ligjshmërinë e arrestimit që pasoi bazuar në të, në pajtim me nenin 41(2) të Ligjit.

Numri i fjalëve (në origjinal): 521 fjalë

/nënshkrim/

XHONATAN ELISTAN RIS QC

Mbrojtësi i specializuar për parashtruesin

VALON HASANI

Bashkëmbrojtësi i specializuar për parashtruesin:

29 shtator 2020

Cardiff, Britani e Madhe